V E N D I M
Nr.137, datë 31.3.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË ÇMIMET E ARTIKUJVE ENERGJITIKË

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, të Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Çmimet e shitjes me pakicë të disa artikujve energjetikë, të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.313, datë 28.6.1993 "Për rritjen e çmimeve e tarifave të disa artikujve të shportës", ndryshohen si vijon:

a) Vajguri .....20 lekë /litri

b) Ngrohja e përqëndruar e banesave:

- Me avull ..... 40 lekë për një m3 mjedis të ngrohur
- Me gaz të lëngët (me bombola)..... 40 lekë/kg
- Me gaz natyror (me tubacione), sipas periudhave:

Prill-Tetor..... 950 lekë/muaj

Nëntor- mars .....1600 lekë/muaj

c) Çmimet e shitjes së druve të zjarrit dhe të qymyrgurit liberalizohen.

Për gjithë artikujt që përfshihen në këtë pikë, shteti ndërpret subvencionimin për diferenca çmimi, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Diferencat ndërmjet çmimeve të reja të shitjes me pakicë të tyre dhe atyre të mëparshme derdhen detyrimisht në buxhetin e shtetit, për sasitë që do të jenë gjendje pranë subjekteve shtetërore përkatëse, në datën e zbatimit të çmimeve të reja të mësipërme.

Organet përkatëse të pushtetit lokal të kontrollojnë dhe të marrin masa për kryerjen e rregullt të inventarizimeve, sistemimin e diferencave të çmimeve dhe derdhjen e tyre në buxhetin e shetit.

2. Çmimet e shitjes së energjisë elektrike ndryshohen si vijon:

a) Çmimi i shitjes me pakicë të energjisë elektrike për përdoruesit familjarë caktohet 4.5 lekë për çdo kilovat-orë të konsumuar në fakt.

Në rastet kur përdoruesit familjarë nuk paguajnë detyrimin përkatës deri në fund të muajit pasardhës, për çdo ditë vonesë paguhet 1 për qind e vleftës së faturës. Me kalimin e këtij afati në 30 ditë, ndërmarrjet shpërndarëse bëjnë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për këta përdorues.

b) Çmimet e shitjes së energjisë elektrike për përdoruesit e tjerë jofamiljarë caktohen:

- 2.1 lekë për çdo kilovat-orë për disa përdorues të sektorëve kryesorë të ekonomisë dhe për përdoruesit buxhetorë.

- Për gjithë këta përdorues do të zbatohet edhe një tarifë fikse mujore e barabartë me 5 deri në 10 për qind të vleftës së faturës për pagesën e energjisë elektrike.

Në përdoruesit e sektorëve kryesorë të ekonomisë përfshihen përdoruesit në sektorin e naftës, të kromit, bakrit, siderurgjisë, gjeologjisë, hidrovoret, si dhe uzinat e prodhimit të plehrave kimike, të prodhimit të sodës së PVC-së në Vlorë, të prodhimit të çimentos, të prodhimit të ujit të pijshëm, si dhe subjektet shtetërore që prodhojnë artikuj dhe kryejnë shërbime që subvencionohen nga shtetit për diferenca çmimi.

- Për gjithë përdoruesit e tjerë çmimet e shitjes së energjisë elektrike dhe tarifat fikse, në përshtatje me mënyrën e furnizimit, mënyrën e matjes së energjisë dhe periudhën e përdorimit, caktohen sipas tabelës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Çmimi i shitjes me shumicë të energjisë elektrike që përdoret nga gjithë konsumatorët (familjarë dhe jofamiljarë), për efekt të ndërtimit të marrëdhënieve me buxhetin e shetit, caktohet 1.1 lekë për çdo kilovat-orë.

Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike cakton mënyrën e faturimit të energjisë elektrike për disa përdorues industrialë (jofamiljarë), të cilët kanë në administrim nënstacione.

Tarifat e shërbimit ndaj kërkesave të përdoruesve për lidhje të reja të furnizimit me energji elektrike dhe për shtesa fuqie të instaluar caktohen nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare.

3. Ngarkohen të gjitha ministritë përkatëse të nxjerrin udhëzime në zbatim të këtij vendimi.

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.507, datë 26.10.1993 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.207, datë 4.5.1993 "Për çmimin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike", si dhe të gjitha çmimet dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfyqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MIMNISTRAVE
Aleksandër Meksi

ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE PER PERDORUESIT
E TJERE JO FAMILJARE

ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRDORUESIT E TJERË JOFAMILJARË

Nr. i përdoruesve Emertimi	Furnizimi nga rrjeti i TL (35 dhe 110 kv)		Furnizimi nga rrjeti i TM (6.,10 dhe 20 kv)						Furnizimi nga rrjeti i TU	
			Matja në nënstacion		Matja në primar të transformatorit		Matja ne sekondar të transformatorit			
	Tarifa fikse Lekë/kw	Çmimi Lek per 1 kwh	Tarifa fikse Lekë/kw	Çmimi Lekë për 1 kwh	Tarifa fikse Lekë/kw	Çmimi Lekë për 1 kwh	Tarifa fikse Lekë/kw	Çmimi Lekë për 1 kwh	Tarif fikse Lekë/kw	Çmimi Lekë për 1 kwh
1.Subjekte prodhuese	40	3.3	50	3.5	50	3.6	50	3.8	60	4.5
2.Subjekte të sferës së shërbimit,tregtimit, hotelet, ente, zyra,reklamë etj., sipas periudhave:										
1 Prill-Tetet	-	-	50	3.0	50	3.2	50	3.4	60	4.2
2. Nëntor-Mars	-	-	50	5.3	50	5.6	50	6.0	60	8.0

SHËNIM: 1. Llogaritja e tarifës fikse bëhet sipas fuqisë së instaluar të transformatorit ose të përdoruesve. Për përdoruesit që do të vendosin limitator (çelës automat), llogaritja e kësaj tarife bëhet në bazë të fuqisë maksimale të limitatorit të vendosur.

2. Në rastet kur përdoruesi kërkon të vendosë matës me dy tarifa (ditë-natë), çmimi i energjisë elektrike të jetë 1.2 herë më i lartë për ditën dhe 0.6 herë për natën, kundrejt çmimit bazë të caktuar për të.